

VENDIM
Nr. 251, datë 3.9.2026

**MBI NJOHJEN DHE LEJIMIN E OPERIMIT TË IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “GREENSOL” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16, 51 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të neneve 13, 14, pika 9 dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të “Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/20 prot., datë 2.9.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi njohjen dhe lejimin e operimit të sistemeve të energjisë elektrike të shoqërisë ‘GreenSol’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “GreenSol” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 22.5.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, për të cilën Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 158, datë 5.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662/5 prot., datë 19.6.2026, ajo ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës, duke shtuar në të dhe elementet e depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar asnjë element tjetër teknik të aplikimit të saj.

- Për sa më sipër dhe në rrethanat kur shoqëria ishte në proces për marrjen e licencës, është vlerësuar se kemi të bëjmë me një përditësim të projektit të centralit fotovoltai, ndaj, me vendimin nr. 179, datë 29.6.2026, Bordi i ERE-s vendosi të ndryshojë vendimin nr. 158/2026, duke pranuar për shqyrtim në këtë fazë përfshirjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë vetëm për fuqinë 49.96 mw.

- Për vendimin e sipërcituar, ERE botoi njoftimin në median e shkruar, në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s në datat 1.7.2026 dhe 2.7.2026. Në përfundim të afatit (data 30.7.2026) ka rezultuar se nuk ka pasur komente apo objeksione.

- Me shkresën nr. 1662/10 prot. datë 14.7.2026, ERE ka njoftuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vendimin nr. 179/2026, ndërsa me shkresën nr. 1662/11 prot., datë 14.7.2026, ERE ka njoftuar “OST” sh.a. për vendimin e sipërcituar.

- Rezulton se në protokollin e ERE-s është administruar shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, sipas të cilës ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë

se ERE i është drejtuar shoqërisë (me shkresën nr.1662/9 prot., datë 14.7.2026), duke i kërkuar qëndrimin e MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 197, datë 21.7.2026, vendosi të pezullojë procedurën deri në administrimin nga ERE të qëndrimit së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE nr. 1662/15 prot., datë 29.7.2026, me anë të së cilës i është kërkuar dhe depozitimi i qëndrimit të MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Rezulton se me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.7.2026, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘GreenSol’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 49.96 mw”, shoqëria “GreenSol” sh.p.k. është licencuar tashmë, për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik me kapacitet të instaluar 41.29 mw. Ky kapacitet është përcaktuar duke iu referuar fuqisë nominale të centralit në rrymë alternative (AC), për të cilën është lëshuar miratimi në parim nga “OST” sh.a. është vlerësuar projekti në kuadër të procedurës së VNM-së paraprake dhe për sa ka rezultuar nga analiza dhe përlllogaritja e prodhimit vjetor të parashikuar në kontratën e nënshkruar me MIE-n, ku nga të gjitha këto dokumente rezulton se totali i kapacitetit të duhet të injektohet në rrjet është 41.29 mw.

- Në vijim, MIE, me shkresën nr. 4755/13 prot., datë 3.8.2026, protokolluar në ERE me nr. 1662/18 prot., datë 5.8.2026, ka sqaruar ndër të tjera, se, në zbatim të nenit 51, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, impiantet në zhvillim ose operim në hyrjen në fuqi të ligjit, pa licencën përkatëse, njihen dhe lejohen të operojnë sipas licencës ekzistuese, në kushtet dhe afatet e përcaktuara nga ky nen. Në këtë kuadër, MIE vlerëson se shoqëria “GreenSol” sh.p.k. mund të vijojë operimin sipas licencës ekzistuese gjatë periudhës tranzitore të parashikuar nga ligji, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në ligj.

- Në kushtet kur sistemet e depozitimit të energjisë elektrike janë deklaruar nga shoqëria, në kuadër të procedurës së licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si pjesë e projektit të centralit fotovoltaik dhe pa rritur kapacitetin e instaluar të tij, duke mbajtur në konsideratë regjimin kalimtar të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe qëndrimin e MIE-s të administruar me shkresën nr. 4755/13 prot., datë 3.8.2026, vlerësohet se këto sisteme do të trajtohen në përputhje me këtë regjim. Njohja dhe lejimi i vijimit të operimit të tyre gjatë periudhës kalimtare nuk përbën dhënie të një licence të re për veprimtarinë e depozitimit dhe as modifikim të licencës së prodhimit apo ndryshim të kapacitetit të instaluar të centralit fotovoltaik.

- Me administrimin nga ERE të qëndrimit të MIE-s, vlerësohet se është përmbushur qëllimi dhe kushti mbi të cilin është bazuar pezullimi i procedurës, sipas pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 21.7.2026. Për rrjedhojë, kushti i përcaktuar në këtë pikë konsiderohet i ezauruar në kuadër të këtij pezullimi.

- Shoqëria ka detyrimin që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë, injektimi i energjisë elektrike në rrjet të mos tejkalojë kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaik prej 41.29 mw.

- Në zbatim të regjimit kalimtar të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, shoqërisë i njihet e drejta e vijimit të operimit të sistemeve të depozitimit të deklaruar pranë ERE-s, deri në përfundimin e periudhës 12-mujore të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, brenda së cilës shoqëria

ka detyrimin të aplikojë për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit, sipas legjislacionit në fuqi.

- Duke qenë se me vendimin nr. 230, datë 18.8.2026, ERE ka miratuar “Rregullat për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, vlerësohet se informacioni dhe dokumentacioni i administruar në këtë procedurë mund të përdoret edhe për qëllimet e njoftimit dhe regjistrimit, duke u plotësuar, kur është e nevojshme, me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Përmbushja e këtyre kërkesave do të trajtohet në kuadër të procesit të njoftimit dhe regjistrimit.

- Pagesa kryer nga shoqëria, në kuadër të veprave ndihmëse, do të rakordohet në vijim me strukturën e financës, duke u marrë në konsideratë në raport me detyrimet financiare të pagesave të rregullimit që shoqëria do të ketë ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të njohë operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike të deklaruar nga shoqëria “GreenSol” sh.p.k., të përbërë nga 29 (njëzet e nëntë) njësi me kapacitet energjetik 6.9 mwh secila, me kapacitet total energjetik 200.01 mwh, dhe të lejojë vijimin e operimit të tij në kuadër të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.7.2026.

2. Shoqëria “GreenSol” sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë që, gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë, fuqia totale e injektuar në pikën e lidhjes në rrjet të mos tejkalojë në asnjë moment 41.29 mw, përkatësisht kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

3. E drejta për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike sipas pikës 1 të këtij vendimi i njihet shoqërisë vetëm për periudhën kalimtare të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Shoqëria ka detyrimin që, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 51 të këtij ligji, të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi për ushtrimin e këtij aktiviteti.

4. Njohja dhe lejimi i operimit sipas këtij vendimi nuk përbën dhënie apo modifikim të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe nuk ndryshon kapacitetin e instaluar prej 41.29 mw, të përcaktuar në licencën e shoqërisë “GreenSol” sh.p.k.

5. Përfundimi i periudhës kalimtare të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi nuk krijon të drejtë për vijimin e operimit të sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike, në kuadër të licencës së prodhimit, përtej rasteve dhe kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se rezulton se të dhënat, dokumentacioni ose rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimmarrja e Bordit të ERE-s kanë ndryshuar ose nuk përputhen me gjendjen faktike dhe juridike të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike.

7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “GreenSol” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova

të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti